



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 28-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28. 02. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Ramadush Tasholli, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Naim Stullca, anëtar
9. Majlinda Sylejmani, anëtare
10. Fatime Krasniqi, anëtare
11. Arif Miftari, anëtar
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës

3. Avni Olluri, drejtor i DA
4. Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
7. Rasim Hasani, drejtor i DSHP
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Anila Reçica, drejtoreshë e DRKS
10. Merita Bytyqi, drejtoreshë DSHMS
11. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
12. Visar Kozhani, zyrtar financiar
13. Xhyste Dabaj, zyrtare për barazi gjinore
14. Besart Troshupa, zyra e informimit
15. Kimete Jashanica, OSBE
16. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
17. Haki Avdiu, zyrtar i teknologjisë
18. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të Kuvendit.
2. Informatë nga KUR "Prishtina"-NjOU-Lipjan, mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të Komunës së Lipjanit.
3. Raporti i shpenzimeve Janar-Dhjetor 2029.
4. Propozim vendim për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2019.
5. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.
6. Propozim vendim për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se me të gjitha votat prezente, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se vazhdojmë me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Majlinda Sylejmani, kam një pyetje për DKA-n pasi që po ndodhemi në një situatë alarmante nga koronavirusi shqetësuese janë fëmijët nëpër shkollë. Deshta me pyet se a janë pajisë me produkte higjienike të gjitha shkollat.

Lulzim Rrustemi, kam dy pyetje nuk e dija a është bërë pranimi teknik në rrugën Lipjan-Konjuh rreth lumit "Janjevka" si dhe pyetja e dytë në Lipjan rruga "Shefki Salihu" është një rrugë afër 200 m pa ndriçim publik a është paraparë pasi që është kërkesë e qytetarëve.

Alban Salihu, kam tri çështje për t'i ngritur e para në Lipjan pirja e duhanit nuk po respektohet. E dyta, shkollë fillore e vjetër "Emin Duraku" në Banullë është në gjendje të mjerueshme çka do të ndërmerret me këtë çështje. E treta rruga Lipjan deri te udhëkryqi në Janjevë edhe kjo është në gjendje jo të mirë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, ka një kërkesë të banorëve të fshatit Jeta e Re për rrugën e shkollës për asfaltim.

Çështja e dytë ka të bëjë me virusin është një udhëzim i ministrisë ku i udhëzon shkollat që të pajisen me mjete higjienike.

Shkelzen Bislimi, kam një pyetje për inspektoriatin a kontrollohen ndonjëherë barrnatores të cilat punojnë gjatë natës. Pyetje e dytë ka të bëjë me shkollën "Ismajl Luma" ku WC e kësaj shkolle janë në gjendje jo të mirë.

Egzona Fazlija, kam dy pyetje për Drejtoratin e Shërbimeve Publike që në fshatin Gumnasellë të bëhet emërtimi zyrtarë i rrugës së familjes Hajrizi si dhe të shtrohet rruga me zhavor. Po ashtu kërkes e banorëve të fshatit Gumnasellë është hapja e kanalit të rruga prej Gumnasellës deri te hekurudha.

Ramiz Qeriqi, është një kompani i autobusave SHPK Lipjani e cila e ka ngrit çmimin e biletës nga 50 cent në 70 cent dhe kjo kompani është e fundit që vije nga Prishtina dhe po i dëmton studentët. Pyetja e dytë ka të bëjë me rrugën Sillovi-Dobratin ku në atë rrugë ka polic të shtritë dhe është mirë që ata polic të ngjyrosen dhe të vërehen nga vozitësit. Tjetra ka të bëjë me shoqatën sindikale ku ata e kanë një lokal dhe aty bëjnë pjesë tri grupe e ai lokal është themeluar me fonde të penzionistëve, është mirë që t'i ndihmoni këta pensionistë pasi që janë lënë anash. E kam një foto të një drejtori gjatë vikendit me vetur zyrtare në komunën e Shtimes nuk e dijë a ka qenë duke punuar apo çka. Po ashtu e kam edhe një foto rreth hekurudhes ku po kryhet ndriçimi publik e që është në gjendje shumë të keqe.

Nehat Tërpeza, është për tu përshëndetur rritja e të hyrave. Kam një pyetje për drejtoreshën e DKA-së rreth paraleleve të ndara në fshatrat rurale të cilat kanë mbetë me nga një nxënës a ka ndonjë plan DKA rreth kësaj çështje. Pyetja tjetër ka të bëjë në Drejtoratin e Shërbimeve Publike ku te një familje në Ribar të madh ka shperther kanalizimi dhe është mirë që të intervenohet.

Fehmi Rexhepi, kam një shqetësim të banorëve të fshatit Hallaq i Vogël ku te varrezat e këtij fshati është një rrugë e pa kalueshme dhe është mirë që të intervenohet të paktën sivjet të zhavorrohet.

Albulena Kelmendi, në seancën e kaluar të Kuvendit pata kërkuar një informatë rreth braktisjes së shkollimit nga nxënësit. Shqetësimi tjetër ka të bëjë me shkollën ku unë jap mësim e në të cilën ende nuk ka mjete dezinfektuese. Ministria e ka bërë një urdhëresë për do broshura kundër virusit por te ne ende nuk i kanë pru. Qe 5 javë në shkollën tonë nuk ka profesor të matematikës. Po ashtu është mirë që afër rrugës të rregullohen kapakët e pusëve të cilët po mungojnë. Shqetësimi i fundit është ai i rritjes së çmimit të biletave nga SHPK "Lipjani"

Nazmi Krasniqi, është dashtë që të kemi një informatë rreth çështjes së suksesit të nxënësve nëpër shkolla si dhe të braktisjes së mësimi. Po ashtu te shkolla "Vllëzërit Frashëri" është filluar që të punohet në rrethojat e shkollës por si duket ende nuk ka përfunduar.

Hyra Bytyçi, kam një shqetësim të banorëve për rreth rrotullimin në Rufc pasi që vozitësit po vozisin me shpejtësi të madhe është mirë që të vendosen masat e sigurisë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës sa i përket mungesës së profesorit të matematikës në shkollën e gjimnazit sipas informatave nga drejtori Semir Gashi, profesori aty mungon që dy javë dhe shumë shpejt do të zgjidhet ajo çështje.

Rruga rreth lumit "Janjevka" do të rregullohet pasi që ende nuk ka pranim teknik por ne po kemi problem edhe me kabllot ilegale të cilat janë këto të kompanive të internetit të cilat po na shaktojnë probleme edhe në shtylla elektrike edhe në trotuar.

Ndriçimi publik në atë rrugë do të zgjidhet. Ish-shkolla "Emin Duraku" në Banullë duhet me pas një alternativ dhe me pasë propozime konkrete rreth asaj shkolle.

I kemi hequr deponit e mbeturinave në të gjitha fshatrat, jemi në proces për shporta për secilën familje.

Rruga udhëkryqi i Janjevës-Lipjan me të drejt e ngritur ne kemi dërguar 5-6 herë shkresë në ministri dhe ajo është çështje e nivelit qëndrorë.

“Ligji i duhanit” është e saktë që nuk po respektohet. Rruga te shkolla në fshatin Jeta e Re është e parapar me buxhet.

Për mjetet higjienike nëpër shkolla nuk e dije por do t'i marrim masat, ndërsa sa i përket çështjes së çmimit të biletave ajo është kompetencë e autoritetit rregullativ të konkurrencës. Çështja e veturës të cilën e ceke kam qenë unë së bashku me drejtorin.

Rruga te varrezat në fshatin Hallaq i Vogël do ta gjejmë një zgjidhje.

Sipas informatave nga DKA-ja braktisja e mësimin nga nxënësit janë prej klasës së parë deri në klasën e dymbëdhjetë janë gjithsej 96 nxënës.

Shkolla Ulpiana qysh në vitin e parë kemi pasur probleme dhe problemi kryesorë janë dritaret dhe dyshemeja me të cilat duhet të merremi.

Mungesa e kapakëve të pusëve do të rregullohen dhe do të vendosen prap ato.

Rrethojat e shkollës në Lipjan ne e kemi shkëput kontratën me atë kompani për shkak të defekteve të cilat i ka pas dhe ja kemi ndërpre punën.

Raportin e punës të Shërbimeve Publike dhe secilit departament do ta keni në seancën e ardhshme.

Sa i përket gripit koronavirusi deri me tani nuk kemi asnjë shpresë nga niveli qendrorë se si duhet të veprojmë.

Unë kam marrë një peticion nga një grup i qytetarëve dhe gjatë analizës dhe verifikimit të letërnjoftimit del që edhe të vdekurit kanë nënshkruar këtë peticion dhe ne nuk dimë se kujna t'i kthejmë përgjigje pasi që në protokolin tonë është regjistruar kërkesa në emër të një grupi të qytetarëve. Ku me këtë peticion janë mashtruar qytetarët se kinse do të vijë gurëthyes të rinjë dhe do të ipen prona të reja por e vërteta është se aty nuk do të vijë asnjë gurëthyes i ri e nuk do të ipet asnjë pronë e re.

Po ashtu kam marrur një peticion tjetër nga këta qytetarë të cilët kanë thënë se janë mashtruar kur kanë dhënë nënshkrimet e tyre.

Po dëgjoj që për ditën e Pavarësisë i paskem hargju 1 mijë euro, në atë shumë prej 950 euro janë përfshirë mëngjesi për mushafir nga Shqipëria, dreka dhe darka për legjislativ dhe ekzekutiv, ku në vitin 2012 janë hargjuar 28 mijë euro.

Të gjitha këto që i ceka po ja epi shefit të grupit parlamentar të PDK-së nëse i pranon.

Ramiz Qeriqi, mua po me duken pak 1 mijë euro që janë harxhu u dashtë edhe më shumë me harxhu me festua. At ditë që po e cek unë nuk ke qenë ti në veturë ka qenë një drejtor.

Nazmi Krasniqi, çdo pronë e cila ipet dhe gërmohet duhet të kthehet në gjendjen e më parshme.

Albulena Kelmendi, gjatë gjithë seancave sa jam unë në kuvend jam mundu me ruajt profesionalizmin, projektet të cilat janë kanë m'u vlerësu na i kemi vlerësu. Unë jam kujdestare në klasën 11/11 dhe është java e 5 të që këta nxënës nuk e kanë mbajtur lëndën e matematikës, nuk e di se çfarë ka thanë drejtori Semiri po unë këtë do të ja argumentoj me ditar në seancën tjetër.

Egzona Fazlija, zotërinë në fjalë unë nuk e njoh dhe kërkesën e tij e kam bërë pa asnjë anim politik dhe as unë nuk e përkrahi shtrembimin patriotik.

Argjend Tasholli, një sqarim të vogël kryetari nuk është mirë me politizo peticionin, parcelat që janë të cekura aty janë të gjitha për tu dhënë për gurthyes. Peticioni është nënshkruar në kundërshtim të dhënies së atyre 4 pronave.

Imri Ahmeti Kryetar i Komunës, kërkoj mirëkuptim nga Albulena nëse jemi keqkuptu se unë veq e interpretova mesazhin e drejtorit, po ashtu edhe ty Egzona nuk e pata për ty po fola si fenomen. Argjend ti i ke politizu nënshkrimet pasi që i ke mashtruar qytetarët dhe është maipulim i 4 personave se ti vet i 3ti e ke derzu edhe vet nuk ke guxu me nëshkru.

Daut Azemi tha se e falemderoj kryetarin e komunës që çdo herë po është i gatshëm me marrë pjesë në seanca me ju përgjigjë pyetjeve të anëtarëve të kuvendit.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes 27-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 27-të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informatë nga KUR “Prishtina”-NjOU-Lipjan, mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmi Bublicës, drejtor, i KUR “Prishtina”-NjOU-Lipjan, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Imri Ahmeti kryetari i komunës, e falemëdoj drejtorin që është këtu, në takimet që i kam pas me kryeshefin e ujësellësit së bashku me drejtorin “Elmiun” kemi diskutuar se cka duhet të ndermarrim që Lipjani me pas ujë. Unë kam shprehë gadishmërinë që komuna me parcitipin në shtimin e burimeve të ujit. Ne kemi hy në marrëveshje me CDU për regjionin e fshatrave Kraishtë e deri te Topliqani.

Une ujsjellisin e shoh përgjegjës për investime si dhe për mirmbajtje të kanalizimeve pasi që është përgjithësi e juve e qytetarët na lojnë fajin neve komunave e kur dihet që ju e merrni tatimin për kanalizim. E kemi një pjesë të fshatrave të Lipjanit që e kanë ujsellsin por nuk kanë pranuar që ti blejnë orëmatit, na duhet me bo përpjekje me i fut në sistem edhe ato fshatra Përgjegjësinë për furnizim me ujë e kanë ujësellësi . Ka qytetarë që çdo muaj ju shkon fatura për pagesën e ujit dhe nuk kanë ujë. Komuna shprehë gatishmërinë e bashkëfinancimit .Unë e di që ju nuk jeni fajtor po duhet me i adresua kërkesat tona. Ose kuvendi do të kërkojë që ne me u nda ku kërkojmë token tonë rrjetin tone dhe ndahemi nga ju? Ne Lipjan ne kohë të dimrit nuk ka ujë te pijes, ky problem nuk është vetëm në Lipjan po edhe në fshatra.

Shkelzen Bislimi, e falemëdojmë drejtorin për informatën, me shqetëson fakti që qytetarët nuk po kanë ujë, po ashtu edhe bizneset e Lipjanit po kanë problem me ujë. Po ashtu edhe uji në Lipjan nuk është i pijshëm.

Arben Salihu, do ti ngris dy çështje: drejtori po ankohet që reshjet atmosferike kanë ndikuar në furnizim me ujë, por në raport thuhet se diku 54% ka humbje. Qytetarët e pa ndërgjegjshëm të cilët e keqpërdorin ujin duhet të ndëshkohen . Qështja e dytë në vendet ku po ka çkyqje të ujit prap po vinë njëjtë faturat.

Lulzim Rrustemi, ky vit ka qenë viti më alarmant në komunën e Lipjanit, ku as vendet rurale nuk kanë pas uje ku shihen kompanite private çdo ditë nëpër fshatra tu hape puse. Nëse na kemi nevojë me investu duhet të investojme ti lejmë edhe asfaltet e punet tjera e të investojmë në ujë për me zgjidh problemin jetësor të qytetarëve. Edhe na si kuvend duhet me marrë veprimet tona dhe me ju dalë përballë kërkesave të qytetarëve. Financat nuk duhet me mungu prej komuës për aq sa kemi na kapacitete me nihami. Jmei ë vedishëm për prishje të rrjetit

po ashtu për mos pagesë nga qytatar nga qytatarët e për këtë jemi përgjegjës na bashkarisht.Na me një afat të gjatë duhet të ju bëjmë një zgjidhje qytatarëve.

Daut Azemi,ju lus që te jepni edhe propozime dhe rekomandime për qështjen e ujit të pijshëm.

Albulena Kelmendi,sa i perket propozimeve i dhan ma heret parafolsit ne veqanti kryetari i cili ke konstruktiv.Une si qytatare e Lipjanit pasojën e mungesës së ujit i vuaj që 3 vjet.Une nuk muj me dhanë rekomandime dhan parafolsit mjaft rekomandime.Eshtë shqetsuese me pagu ujin qytetarët e mos me pas ujë.Kompania e ujsjellsit nuk mundet me qenë komode pasi që gjenja me ujë të pijshëm ne Lipjan është alarmante.

Ukë Kryeziu,ne si asamblesit pa dallim pozitë e opozitë kemi ngritë shqetësimet rreth ujit të pijshëm. Mua po me vjen mire për arithen e kësaj marrëveshje në mes të komunës dhe ujësjellësit për rritjen e kapaciteteve te ujit të pijes .Duhet ti lëmë disa projekte e të kthehemi te uji i pijes. Sa i përket burimeve të ujit në Sllovi,unë e kam cekur disa herë se Sllovia ka kapcitet per zgjerimin e burimeve të ujit të pijshëm,mirëpo është thane qe nuk kemi mjete.Falë punës në autostradën Banullë Gjilan gjat punës kan dalë se ka ujë të pishshëm të mjaftushëm për fshatin Sllovi.Me nje investim simbolike në atë pjesë qytetarët e Sllovisë nuk do ta kenë më problem ujin e pijshëm. Kam një pyetje deri ku ka shku procesi rreth ati burimit të ujit të pijes,pasi që është një pasuri e çmueshme për at lokalitet.

Alban Salihu,pajtona me shqetësimet qe i ngritën kolegët,por desha një sqarim se u tha qe dikun 30% nevojiten me ju shtu kapacitetet dhe humbjet qenkan dikun 54 % më intereson ku ndodhin këto humbje dhe sa janë mundësitë që të zvogëlohen këto humbje që të plotësohet pjesa e nevojshme për ujë.

Fehmi Rexhepi,në Medvec që 3 vite nuk është zgjidhur problemi me ujë të pijshëm,disa here kam qenë te drejtori për këtë çështje mirëpo ende nuk është zgjedhur problemi,sidomos nje lagjen ne pjesën e nalt të fshatit nuk ka kurrë ujë. Kërkoj nga ana e juaj që të i bëhet sa më shpejtë një zgjidhje këti fshati e në veçanti kësaj lagje.

Ramiz Qeriqi,une i kam dy kërkesa njëra që të riparohen gypat mbrapa hekurudhës.Gypi ku bëhet ndalja u ujit nëse ka ndonjë problem është shumë vështirë me ndal pasi qe vendi është shumë keq dhe ka ndodhë qe kur kanë ardhë punëtorët nuk kan pas guxim per ty hy për ta ndale aty për shkak te fellsisë qe ka aty. A jeni në bashkpunim me komunën e Lipjanit pasi qe nderimet qe po bëhen në atë pjesë a e dëmtojnë ato ndërtesa rezarvarët. A kanë me i mbulu krejt me ndërtesa ata rezervarë apo do tju lihet hapsirë atyre rezervarëve.

Bashkim Budakova,a ka naj strategji për furizim me ujë për fshatrat Rubofc dhe Kojskë,pasi qe ujësjellësi ekziston por qytetarët kurr nuk e kanë gëzuar të drejtën me pas ujë.

Khuzide Rrusetmi,kam disa pyetje për ti ngritur,kur do të kemi ujë 24 orë? Nëse nuk keni kapacitet per furnizim me ujë pse nuk njoftohen qytetarët për problemet me furnizim të ujit?Pse ujësjellësi nuk i ndalë keqpërdorimet pasi qe po pësojnë konsumatorët e ndërgjegjshëm?Kërkoj nga ana e juaj qe të ketë menaxhim më efikas.

Afrim Miftari,me sa po shihet edhe drejtori po pajtohet me neve qe gjendja me ujë të pijshëm nuk është e kënaqshme para disa seancave është thane qe është formua një taskë forcë,kisha dashtë me ditë cilat janë veprim qe i kam marrë kjo taskëforcë në teren dhe qeshja e dytë do të ishte mire qe na me bërë një shkresë për nivelin qendror dhe le ta shohin qe gjendja është alarmante me furnizim me ujë në Lipjan?

Daut Azemi,edhe une e kam një pyetje rreth disa puseve dhe në Babush janë marrë mostrat,a ka rezultu qe mujna me u furnizu prej atyre puseve?

Elmi Publica drejtor i "KRU"Prishtina,është e vërtetë qe me rregullore na e kemi mirëmbajtjen dhe rregullimin e kanalizimeve,deri sivjet ne nuk kemi mujt me bo mirëmbajtjen e ka bo komuna,por tash e tutje do ta bëjme ne.Te bartja e kompetencave ne jemi te gatshem nëse na lejohet me ligj.Ne kemi filluar ta monitorojmë online furnizimin me ujë.Na shkaktojn probleme dhe energjia elektrike si dhe prishjet e shpeshta.Burxhet janë të mëdha.Bizniset e vogla kan 24 orë ujë me përjashim te prishjeve po ashtu edhe Sllovia është pa reduktme.Humbjet e ujit janë shumë të mëdha po ashtu edhe keqpërdorimet,ku heren e fundit

na është sulmuar nje puntor i joni ne teren.Në Konjuh nuk mujna me hap me puse se nuk kemi më sipërfaqe.Në ndërtesat e larta deri ne 1.5 bar është i obliguar pronari me siguru ujin sipas nje udhizimi adminsitrativ.Në Sllovi është marrë mostra është analiza por duhet te bëhet nje rezervar i mire pasi qe është afër rruga.Në Lipjan uji është i pijshëm.Ende kompania deri me sot nuk ka mujte me i definu humbjet u jiti të pijshem disa janë teknike disa keqpërdorime.Në Medvec situatë nuk është mirë jemi ne bisedime me KFOR-in dhe CDI per ndrrim të rrjetit komplet në ujësjellës.Puseta qe e cekti Raimizi puntoret dotn mundet me hy sa here qe ka nevojë.Në Rubofc dhe Kojskë është ujësjellsi po pritët me u gjete doantort për puseta dhe ujëmatës siç ka qenë Dobraja e fshtrat per rreth.Ujë 24 orë kemi në Lipjan kur te vedisohe mi ne mos keqpëdrime,pagesa të rregullta. Në Basbush është bërë mostra por nuk është uji i pijshëm.

Ganimete Qeriqi,mimentin qe ndalet uji e pastaj kur vjen nëse e mbush gotën me ujë,uji është i turbulluar dhe le qe nuk është për pije por as për shërbime higjienike e pastrimi kur vjen ne qatë cilësi uji nuk e di qysh mundet me kanë i pijshëm.

Albulena Kelmendi,unë jam qytetare e Lipjanit,në qytetin e Lipjanit nuk kemi ujë të pijshëm .Paska dalë një rregullore qe i obligon pronarit e ndërtesave me e siguru ujin,po ku me gjetë qytetari pronarin e ndërtesës .Çka kam une faj qe proanri i ndërtesës nuk e ka instalua rezervarin e ujit,para pak kohe kam pas një ankesë nga disa qytetarë ku nuk i ka lanë pranri i ndërtesës me insatlu rezervarin e ujit.

Elmi Biblica,është e vërtetë qe mund të ketë ndodhë tullbullirë te ujit por ajo ndodhë kur ka ndonje defekt.Asnjë ankesë neve nuk na është bër me shkrim neve në ujësjells.

Ukë Kryeziu,ju gëzojme faktit qe ka ka një marrëveshje për ujë,Sllovija qe 3 muj nuk ka pas reduktme.

Imri Ahmeti, rendësin qe e ka kjo temë edhe unë jam prezent ktu ,prita qe do te ketë ndonjë rekomandim nga asambleja komunale por duhet me bër një kërkesë asambleja komunale qe ujsjellsi me u marre ma seriozisht pasi qe e ka obligim me ligj dhe te bej zgjidhjen e problemit me uje te pisjhem per qytetarët e Lipjanit Ky kuvend duhet me nxjerr Rekomandim qe ujësjellsi mos me lshu pelqim banesave shumë etazhore pa e ditë a do te ketë ujë në atë ndërtesë.Rekomandimin tjetër qe DPU te mos lëshoj leje pa e siguruar rezervarin e ujit pronarët e ndërtesave.Ujësjellsi duhet me indentifiku dhe rekomandu qysh me zgjedhë problemin e ujit.Kuvendi shprehe gadishmërine qe me zgjidhë këtë problem.

Pastaj u shkua në pauzë nga ora 12:30 deri në ora 13:45

Dauta Azemi kryesuesi i Kuvendit tha se ftoj nga një përfaqësues të subjekteve politike në kuvend të bisedojmë rreth rekomandimeve për qeshtjen e KRU-Prishtina.

Pas propozimeve te marra nga ana juaj dhe nga ana e Kryetarit të komunës dhe gjatë takimit me perfaqesuesit e subjektve politike vendosëm ti marrim këto rekomanime,pastaj në mënyrë zyrtare ti dërgojme në autoritetet përkatëse.

REKOMANDIM:

1. Kompania e ujësjellësit KRU-“Prishtina” në objektet shumë banesore ,shumë etazhore të mos u jap pëlqim për kyçe në ujësjellës pa i pas kapacitetet e mjaftueshme të furnizimit me ujë dhe pa u siguruar se do të ketë ujë të mjaftueshëm për atë objekt.

2. Kompania e ujësjellësit KRU-“Prishtina” mos të jap pëlqim në objektet shumë banesore, shumë etazhore nëse këto objekte nuk e kanë rezervarin për ujë.

3. Drejtorati për Planifikim dhe Urbanizëm,mos të lëshojë leje ndërtimi për objektet shumë banesore,shumë etazhore nëse këto nuk e kanë të paraparë në projekt vendosjen e rezervarëve për ujë.

4. Kompania e ujësjes KRU-“Prishtina” të identifikojë veprimet e nevojshme për furnizim me ujë 24 orë dhe të sjellë projekte konkrete me të cilat kërkohet mbështetje financiare, me qëllim të përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm në Komunën e Lipjanit.

5. Kompania e ujësjes KRU-“Prishtina” obligohet që t’i informojë me kohë konsumatorët rreth reduktimeve apo problemeve tjera rreth furnizimit me ujë të pijes.

Pastaj kryesuesi këto rekomandime i vuri në votim rekomandimet e marrura nga kuvendi dhe me 29 vota për u votuan nga anëtarët e kuvendit.

Me që diskutime të tjera rreth kësaj pike nuk pati, u kalua në pikën e tretë të rendit të ditës.

III

Raporti i shpenzimeve Janar-Dhjetor 2029.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, një raport i mjaftueshëm për ti parë edhe sfidat edhe të arriturat gjatë këtij buxheti. Një buxhet i konsoliduar mirë. Nëse e shikojmë sipas fondeve burimore kur i krahasojë mbetjet është sfidë dhe ka përgjegjësi për mos shfrytëzimin e plot të këtij buxheti. Te buxheti të shpenzimet sipas kategorive ekonomike të pagat dhe menditjet kemi shpenzim të mirë. Kam një pyetje pse nuk janë shfrytëzuar 247 mijë euro për paga të subvencionet dhe transferet është një shpenzim më i mirë këtë vit. Te buxheti dhe shpenzimet nga grantet qeveritare të rrogat dhe pagat cilat kanë qenë arsyet që nuk kanë mut me u shfrytëzuar mjetet, pse këto mjete duhet të kthehen në qeverinë e Kosovës pasi që janë një shumë e bukur e mjeteve. Po ashtu të arsimi kemi ende nevojë për investime, e ne nuk i shfrytëzojmë 18 mijë euro grant qeveritar. Te shpenzimet komunalenjë shpenzim i mirë. Po ashtu të investimet kapitale të pa shfrytëzuara mjetet. Te të hyrat vetanake të bartura nga rrogat dhe pagat nuk është shfrytëzuar asnjë mjet që është parapa. Mallrat dhe shërbimet një shfrytëzim i mirë. Te zyra e kryetarit për rroga dhe paga pse gjithë këto mjete të pa shfrytëzuara. Te shërbimet publike të të hyrat vetanake i ulët shfrytëzimi. Në bujqësi si shtundcone pak janë shfrytëzuar, të Rini Kulturë Sport mirë i shfrytëzuar. Te arsimi një shfrytëzim jo i mirë.

Janë disa projekte të planifikimi i vitit 2019 ku janë planifikuar shumë tjetër kurse në vitin 2020 shumë tjetër. Janë dikur 37 projekte që kanë diferencë të planifikimit dhe shpenzimit. Po ashtu janë 8 projekte që nuk kanë filluar fare.

Ne si grup parlamentarë mendojmë që ka qenë një menaxhim i dobët dhe duhet më shumë me u punë.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentarë i LDK-së e kemi analizuar Raportin e shpenzimeve për periudhë Janar-Dhjetor 2019 dhe mendojmë që ka një buxhet të realizuar mirë, po ashtu të të hyrat vetanake që e kanë kaluar shumën e planifikuar me çast e kanë kaluar tavanin buxhetorë ku ka pas një rritje pozitive. Po ashtu të investimet kapitale është realizu mirë krahasuar me planifikimin. Po ashtu të hyrat nga tatimi në pronë kanë shënuar rritje. Duke i parë sfidat me të

cilat është perballë drejtrati për buxhet,ne si grup parlamentar i inkurajojmë që të tregohet maturi nëmenaxhim dhe ju urojme të realizojnë shumë projekte.

Lumturije Bytyqi-Hasani,une do të ndalem te lëndët e egzekutuara nga thesari ku po thuaj komunës çdo vit po i merren mjete nga projekte nëpër kode të caktume.Ku kemi lista te puntorve qe kërkojnë pagën jubilarë qe ju takon sipas kontratës kolektive sektoriale,e ku lista të tilla do te kemi edhe me tutje.Pse nuk po palnifikohen paga kur e dim sa e kemi numrin e punëtorëve dhe do te ishte mirë qe komuna me i planifiku këto mjete edhe për paga jubilarë edhe për paga në rast pensonimi.

Latif Ramadani,të hyrat qe grumbullohet 3mujt e fundit dhe nuk munden me u shfrytzu.Te pagat u kan një ligj i pagave për rritje të pagave,na i kena planifiku ato mjete. Te subvencionet te zyra e kryetarit ka pase marvehsje me Jetimat e Ballkanit e shume organizata tjera per nevoja te qytatarëve.Në bujqësi kanë tepru mjetet se ka ofertu opertari me i lirë edhe ato mjete kan mbetë.Pagat jubilarë ne per vitet ne vazhdim i kena planifiku.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi

IV

Propozim vendim për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani , drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi,ne si grup parlamentar e përkrahim rritjen e të hyrave,por kur të bëhet planifikimi te shkollat është mirë me i ditë emrat e shkollave në cilat shkolle të specifikohet.

Albulena Kelmendi,edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë rritje,pajtohen për emërtimin e shkollave se këta edhe dje ne KPF e kemi cekë,jam shumë e lumtur për punën e këtyre pjerrinave qe do të bëhen në qytetin e Lipjanit dhe në vendet ku ka nevojë. Po ashtu kemi diskutua që shikohen edhe ato pjerrinat qe janë në objekte private apo publike pasi qe disa prej tyre nuk i plotësojnë shumë kushtet.

Hyra Bytyçi,ne si grup e përkrahim propozim vendimin për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2019 ajo qe është me rendësi qe tani kemi mjete edhe për projekte te reja.

Afrim Miftari,është lajm i mirë kur kemi rritje të hyrave dhe kjo ka rezulto me një menaxhim efikas dhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim.

Latif Ramadani,shkollat qe do te përfshihen Adem Gllavica Nezë Bujani etj

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

V

Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu,është një shumë bukur e mirë ku mundt të panifikohet të investohet në ato projekte qe janë me prioritet. Unë do ta ngris shqetësimin e banorëve të fshatit Sllovi për Rrugën Sllovi Lipjan është projekt i vitit 2011ku e kam një ankesë qe një kompani ka fillu punën

por projekti ska përfund disa here kam ber pyetje për këtë por edhe kryetari edhe drejtori janë përgjigje se janë ne proces gjyqësor .Kam prite sikurse ne projektet tjera qe asnjë kompanie ti ndërpritet puna te ritenderohet . Kërkoj nga ana juaj ti merrni te gjitha masat dhe te beni perfudimin e asaj rruge pasi qe komania ne fjale ka falimentu .Ju bej thirrje qe me këtë rritje te buxhetit ti behet nje zgjidhje asaj rruge.

Lulzim Rrustemi,te tabela nr 14 janë përsëritë te nejtat projekte qe me herët i aprovuam ?

Latif Ramadani,ajo pjese është shqetësim i te gjithave dhe aty ku ka proces gjyqsor ne nuk nderyjme.Mundesine me te vogel do te bëjmë diçka qe te mundemi. Mjetet qe kanë mbet janet 12 dhe 13.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 votat për, aprovoi këtë:

VI

Propozim vendim për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiq, drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi,kemi ardhe ne fazën finale dhe unë mendoj qe nuk duhet parcela e pronarit të ndërrohet me pjesën te tregu pasi qe ajo parcelë është shumë e nevojshme për qytetarët e Lipjanit qe aty të ndërtohet një shkollë fillore apo të bëhet një park.Po ashtu edhe kompensimi prej 390 mijë euro është i gabuar.Une jam qe propozimi i parë te kaloj dhe asaj parcele me harta zonale ti ndërrohet destinomi dhe ti epet leja për ndërtim,kjo do te ishte zgjidhja me e mire për komunën tone dhe ky do te ishte dëmtimi minimal qe do ti behej komunës tone.

Lulzim Rrustemi,do te duhej kjo lënde te jete edhe me e kompletuar nuk i kemi vendimet e gjykatës as te Ministrisë, Propozimet e dhëna,sa i përket propozimit te pare na nuk jemi për ndërhyrje ne shesh propozimi i pare nuk duhet te shkoj. Propozimi i dyte çmimi qe është dhëne 65 mijë euro për ari,edhe pse ne Lipjan nuk ka as çmim te tille po ne si grup parlamentar i PDK-s jemi te shkoj propozimi i dyte te behet pagesa .Për pronën e 3 te tregu vlerësimi është jo real,na mendojmë qe komunës me se paku do ti kushtoj për propozimin e dyte.

Ramiz Qeriqi,mendimi im është qe ose te blihet prona ose ti lejohet te ndërtohet ne shesh, e assesi te nderohet me parcelën te tregu,pasi qe ajo është e nevojshme për ndërtimin e një shkolle apo diçka tjetër.

Daut Azemi,na jemi këtu për ti zgjidhur problemet e qytetarëve, për atë i kemi marr votat e qytetareve.

Arben Salihu,mendoj qe tregu duhet te bie nga opsioni,kompensimi mendoj qe është e dëmshme edhe për komunën edhe për pronarin,unë propozoj qe te shkojmë me ndryshimin vijës se sheshit edhe pronarit ti epet leja për ndërtim.

Afrim Miftari,ne si grup parlamentar i kemi analizua te tri propozimet qe na kanë ardhe. Na kemi mëndu qe te shkoj propozimi i pare te pajiset me leje duket i zhvillu te gjitha procedurat e nevojshme.

Nehat Terpeza,edhe ne si grup parlamentar i kemi shqyrto këtë propozim vendim dhe e dime qe secila parcele ka peshën e vet. Ne mesin e 3 propozimeve na jemi qe te shkoj propozimi i pare.

Alban Salihu,une jam kundër një vendimi qe ai te gjeneron te hyra të mëdha,unë jam për propozimin e parë qe ti kufizohet ndërtimtaria dhe veprimtaria ne atë pjese,me shprese qe ne te ardhmen te hetohet se çka ka ndodhe me at prone.

Ukë Kryeziu, ne jemi te zgjedhurit e popullit dhe duhet te marrim vendime, veprimet tona janë si per te mire ashtu edhe për te keq edhe për gjeneratat e ardhshme, dhe duhet çdo gjë te analizohet dhe te nxirret vendimi sa ma i drejte. Vlerësimi nga ministria nuk ka qen i drejte për pronat publike .Ne për cilin do propozim qe e votojmë duhet me pas edhe arsyetimin, nuk o qëllimi jone me dëmtua pronarin, propozimi i tret te tregu nuk vjen ne shprehje por për këto dy te parat duhet një analize, unë jam per propozimin e dyte te paguhet shuma 390 mijë euro. Unë mendoj qe propozimi qe ne te ardhmen do te kete pasoje me se paku eshte propozimi i dyte me vlere monetare.

Daut Azemi, komuna ka kontestua vlerësimin e çmimit dhe na është kthye prej Gjykatës dhe nuk e ka njoftë kundërshtimin e komunes por ja ka njofto komisionit qe e ka vlersu. Rrugët gjyqësore te gjitha janë ndjek.

Nazmi Krasniqi, një qeshje mjaftë komplekse, une mendoj qe propozimi i pare është jo i drejte. Une mendoj qe le te behet ndertimi ne pjesen e vet le ti epet leja ndërtimore

Albulena Kelmendi, na e kemi cek edhe ne komitet dje po edhe me herët ne kuvend qe është nje qeshje e ndishme kjo pune, Mua po me duken shume afër gjysme milioni me i dhanë komuna me i nda prej shume projekteve, pasi qe kemi shume projekte te rëndësishme te cilat presin me u përfund. Për tregun nuk ja vlen me diskutua dhe na jena kundër dhënies se tregut si grup parlamentar.

Emina Rexhiq, une e kam përgatite materialin ne paver point po për shkak te kohës mos me ju marr nuk e pas te arsyeshme. Une pres qe ju te votoni për njërin nga propozimet.

Ganimete Qeriqi, unë kur i kam analizu 3 propozimet e kam pa qe e para te jetë ma e arsyeshme dhe ne si grup parlamentar jemi për propozimin parë.

Imri Ahmeti Kryetari i Komunës, është një temë qe jan shterë të gjitha veprimet ligjore, plani rregullativ komunal nuk lejon me u ndryshu vija pa kalu nje kohë. Vlerimin e ka bo Ministria dhe ne i kemi shfrytzu te drejten tone ne dy shkalle gjyqësore dhe neve na obligojne mi gjetë zgjidhje kesaj situate. Cila qe ju duket ma e arsyeshme juve si asamblesite ne do ta procedojmë me tutje. Po ashtu pala do te ketë edhe te drejtën e ankimimit .

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi tha pasi qe kemi tri propozime do te qes ne votim secilin propozim vet, nëse nuk kalon i pari shkoj me te dytin nëse as i dyti nuk kalon shkojmë me te tretin e nëse kalon i pari ndërpret votimi.

Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se prpozimi i parë parcela kadastrale P-71409044-01745-0 në vendin e quajtur “Varosh” me sipërfaqe prej 753m2 Zona Kadastrale Lipjan në pronësi të Ismajl Jahirit të përfshihet në plotësim dhe ndryshim të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Lipjanit 15Nr.12514 dt.23.08.2013, kalon me 21 vota për, 6 vota kunder 2 abstime.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:¹⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi